



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 137

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E martë, 25 shtator 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 10875, datë 18.9.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 9293
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 30, datë 12.9.2018	Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar..... 9293
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Rinisë nr. 31, datë 13.9.2018	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 18, datë 21.5.2018 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2018– 2019”, të ndryshuar..... 9300
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 34, datë 10.9.2018	Për zbatimin e ligjit nr. 45, datë 19.7.2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës”..... 9300
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 35, datë 10.9.2018	Për përcaktimin e procedurës për përzgjedhjen e zhvilluesit në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në procedurën me aplikim, në pronë private..... 9304
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 634, datë 14.9.2018	Për ndryshimin e udhëzimit nr. 3909/1, datë 4.10.2016, “Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave për ushtrimin e veprimtarive në ujërat detare nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë”..... 9307
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 582, datë 17.9.2018	Për disa ndryshime në urdhrin nr. 185, datë 19.4.2018, “Për ngritjen e tri qendrave rajonale rinore”..... 9308

Urdhër i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar nr. 214, datë 14.9.2018	Për delegim të përkohshëm të kompetencave.....	9309
Udhëzim i Komisionerit për të Drejtën e Informacionit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 47, datë 14.9.2018	Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha.....	9309
Udhëzim i Komisionerit për të Drejtën e Informacionit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 48, datë 14.9.2018	Për certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre.....	9316
	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), datë 14.9.2018.....	9320
Kërkesë e Ministrisë së Brendshme nr. 709/10, datë 11.9.2018	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Asfaltim i rrugës ‘Kodërmalekaj’, Bashkia Lezhë”	9325
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 11641, datë 14.9.2018	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rishikimi i projektit “Vlora-ACU, rikualifikim urban në qytetin e Vlorës, përgjatë shëtitores ‘P4_C2_a, b, c’”	9326
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Eduart Kamberaj.....	9328

**DEKRET****Nr. 10875, datë 18.9.2018****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Jetë Jonuz Aliu
2. Hikmete Mehmet Imeraj
3. Teuta Ismail Avdimetaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

UDHËZIM**Nr. 30, datë 12.9.2018****PËR NUMRIN E NXËNËSVE PËR
KLASË DHE NORMAT E PUNËS
MËSIMORE NË INSTITUCIONET E
ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “d”, të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Numri i nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar të jenë:

I. ARSIMI PARASHKOLLOR**A. Numri i nxënësve në grup/klasë
përgatitore**

1. Grupet e veçanta të nxënësve në kopshtet me ushqim në zonat urbane të formohen me jo më pak se 25 nxënës që frekuentojnë.

2. Grupet e veçanta të nxënësve në kopshtet e zonave rurale të formohen me jo më pak se 15 nxënës që frekuentojnë.

3. Grupet e përziera të nxënësve në zonat rurale të formohen me jo më pak se 10 nxënës që frekuentojnë. Në rastet kur ky numër nxënësish nuk sigurohet, me miratim të njësisë së vetëqeverisjes vendore mund të formohet grup me jo më pak se 5 nxënës që frekuentojnë.

4. Klasat përgatitore funksionojnë në kopshte ose shkolla të arsimit bazë dhe frekuentohen nga nxënës 5 vjeç që nuk kanë ndjekur arsimin parashkollor. Klasa përgatitore në zonat urbane të formohet me jo më pak se 25 nxënës, ndërsa në zonat rurale me jo më pak se 10 nxënës.

**B. Numri i drejtuesve në arsimin
parashkollor**

1. Kopshtet me ushqim ose pa ushqim që kanë të paktën 4 grupe të veçanta ose të përziera të kenë një drejtues të institucionit arsimor.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kopshtet që veprimtarinë e tyre e zhvillojnë pranë shkollave 9-vjeçare, mund të emërojnë një drejtues kopshti për jo më pak se 5 grupe nxënësish.

**C. Norma mësimore javore e drejtuesve
dhe e mësuesve në arsimin parashkollor**

1. Drejtori i kopshtit: 18 orë në javë.

2. Drejtori i kopshtit i përcaktuar në pikën B/2 të këtij kreu: 15 orë në javë.

3. Mësuesi i kopshtit: 30 orë në javë.

D. Norma e vlerësimit të arritjeve

Drejtori i kopshtit: 6 orë në javë.

II. ARSIMI BAZË**A. Numri i nxënësve për klasë**

1. Klasat e veçanta në zonat urbane të formohen me jo më pak se 15 nxënës dhe në zonat rurale të formohen me jo më pak se 10 nxënës.

2. Ndarja e klasave në paralele të bëhet sipas këtij rregulli:

a) Dy klasa paralele, kur numri i nxënësve është 32–65;

b) Tri klasa paralele, kur numri i nxënësve është 66–99;

c) Katër klasa paralele, kur numri i nxënësve është 100–133;

d) Pesë klasa paralele, kur numri i nxënësve është 134–167.



3. Ndarja e nxënësve në më shumë se pesë klasa paralele vazhdon sipas rregullit të përcaktuar në pikën 2.

4. Numri i punonjësve mësimorë në arsimin fillor të llogaritet një mësues për çdo klasë.

B. Formimi i klasave të bashkuara

Në institucionet arsimore, kur nuk plotësohet numri i nxënësve në përputhje me pikën A/1, të kreut II, të këtij udhëzimi, mësimi të organizohet me klasa të bashkuara. Numri i klasave të bashkuara përcaktohet sipas këtij rregulli:

1. Në arsimin fillor (klasat I–V)

a) Një klasë, kur numri i nxënësve në klasat I–V është deri në 10.

b) Dy klasa, kur numri i nxënësve është 11–25.

c) Tri klasa, kur numri i nxënësve është 26–50.

d) Klasa të veçanta, kur numri i nxënësve i të gjitha klasave I–V është mbi 50, pavarësisht nga numri i nxënësve për klasë.

2. Në arsimin e mesëm të ulët (klasat VI–IX)

a) Një klasë, kur numri i nxënësve në klasat VI–IX është deri në 10.

b) Dy klasa, kur numri i nxënësve është 11–25.

c) Tri klasa, kur numri i nxënësve është 26–40.

d) Klasa të veçanta, kur numri i nxënësve i të gjitha klasave VI–IX është mbi 40, pavarësisht nga numri i nxënësve për klasë.

C. Numri i drejtuesve

1. Kur numri i nxënësve është më shumë se 80, emërohet një drejtor shkolle.

2. Kur numri i nxënësve është 251–500, emërohet një nëndrejtor shkolle.

3. Kur numri i nxënësve është 501–900, emërohen dy nëndrejtorë shkolle.

4. Kur numri i nxënësve është mbi 900, emërohen tre nëndrejtorë shkolle.

5. Kur numri i nxënësve është mbi 200 dhe drejtorja ka në vartësi 4 shkolla, emërohet një nëndrejtor.

Kur numri i nxënësve është më pak se 80 nxënës caktohet një kryemësues për të paktën 4 mësues.

Numri i nxënësve të kopshteve që zhvillojnë veprimtarinë e tyre pranë shkollave dhe nuk administrohen nga drejtues kopshti sipas pikës B, të kreut I, të këtij udhëzimi, të llogaritet në numrin e përgjithshëm të nxënësve të shkollës.

D. Norma mësimore javore e mësuesve dhe e drejtuesve

1. Edukator në institutet e fëmijëve me aftësi të kufizuara: 30 orë në javë.

2. Mësuesi dhe kryemësuesi në arsimin fillor e kanë normën javore, aq sa orë mësimore janë në planin mësimor të klasës ku jep mësim. Brenda normës javore përfshihen edhe orët e punës si mësues kujdestar.

3. Mësuesi i gjuhës shqipe, i gjuhës së huaj, i matematikës, i fizikës, i biologjisë, i kimisë, i informatikës, i historisë, i gjeografisë, mësuesi në shkollat e arsimit special: 20 orë në javë.

4. Mësuesi i lëndëve të tjera: 22 orë në javë.

5. Kryemësuesi në arsimin e mesëm të ulët: 20 orë në javë (përgjigjet për disiplinën dhe inventarin e shkollës).

6. Drejtori i shkollës me 81–300 nxënës:

8 orë në javë.

7. Drejtori i shkollës me 301–600 nxënës:

6 orë në javë.

8. Drejtori i shkollës me 601–900 nxënës:

4 orë në javë.

9. Drejtori i shkollës me mbi 900 nxënës:

nuk jep mësim.

10. Nëndrejtori i shkollës: 8 orë në javë.

Drejtori dhe nëndrejtorët e shkollës e plotësojnë normën mësimore javore vetëm me orë të profilit të diplomës që zotërojnë.

Nëndrejtori/nëndrejtorët ngarkohen për amznën dhe inventarin e shkollës.

E. Norma e vlerësimit të arritjeve

1. Drejtori i shkollës me 81–900 nxënës: 4 orë në javë (3 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkolle).

2. Drejtori i shkollës me mbi 900 nxënës: 3 orë në javë (2 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkolle).

3. Nëndrejtori i shkollës: 4 orë në javë (3 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkolle).

4. Nëndrejtori i shkollës me mbi 900 nxënës: 3 orë në javë (2 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkolle).

III. ARSIMI MESEM I LARTË, GJIMNAZ

A. Numri i nxënësve për klasë

1. Klasat në zonat urbane të formohen me jo më pak se 25 nxënës dhe në zonat rurale me jo më pak se 15 nxënës.



2. Ndarja e klasave paralele të bëhet sipas këtij rregulli:

a) Dy klasa paralele, kur numri i nxënësve është 36–70 nxënës.

b) Tri klasa paralele, kur numri i nxënësve është 71–105 nxënës.

c) Katër klasa paralele, kur numri i nxënësve është 106–140 nxënës.

d) Pesë klasa paralele, kur numri i nxënësve është 141–175 nxënës.

e) Ndarja e nxënësve në më shumë se pesë klasa paralele vazhdon sipas rregullit të përcaktuar në pikën 2.

B. Numri i drejtuesve

1. Kur numri i nxënësve është 251–500, emërohet një nëndrejtor shkolle.

2. Kur numri i nxënësve është 501–900, emërohen dy nëndrejtorë shkolle.

3. Kur numri i nxënësve është mbi 900, emërohen tre nëndrejtorë shkolle.

C. Norma mësimore javore e mësuesve dhe e drejtuesve

1. Mësuesi i gjuhës shqipe dhe i letërsisë: 18 orë në javë.

2. Mësuesi i gjuhës së huaj, i matematikës, i fizikës, i biologjisë, i kimisë, i informatikës, i historisë, i gjeografisë, i teknologjisë, i shkencave shoqërore (filozofi, psikologji, qytetari, sociologji), i ekonomisë: 20 orë në javë.

3. Mësuesi i lëndëve të tjera: 22 orë në javë.

4. Drejtori i shkollës me 81–300 nxënës: 8 orë në javë.

5. Drejtori i shkollës me 301–600 nxënës: 6 orë në javë.

6. Drejtori i shkollës me 601–900 nxënës: 4 orë në javë.

7. Drejtori i shkollës me mbi 900 nxënës: nuk jep mësim.

8. Nëndrejtori i shkollës: 8 orë në javë.

Drejtori dhe nëndrejtorët e shkollës e plotësojnë normën e tyre mësimore javore vetëm me orë të profilin të diplomës që zotërojnë.

Nëndrejtori/nëndrejtorët e shkollës ngarkohen për amzën dhe inventarin e shkollës kur shkolla nuk ka sekretar.

D. Norma e vlerësimit të arritjeve

1. Drejtori i shkollës me 81–900 nxënës: 4 orë në javë (3 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkolle).

2. Drejtori i shkollës me mbi 900 nxënës: 3 orë në javë (2 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkolle).

3. Nëndrejtori i shkollës: 4 orë në javë (3 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkolle).

4. Nëndrejtori i shkollës me mbi 900 nxënës: 3 orë në javë (2 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkolle).

IV. ARSIMI I ORIENTUAR

A. Numri i nxënësve për klasë

1. Klasat e veçanta të formohen me jo më pak se 15 nxënës.

2. Ndarja e klasave paralele bëhet sipas këtyre kushteve:

a) Dy klasa paralele, kur numri i nxënësve është 36–70 nxënës.

b) Tri klasa paralele, kur numri i nxënësve është 71–105 nxënës.

c) Katër klasa paralele, kur numri i nxënësve është 106–140 nxënës.

d) Pesë klasa paralele, kur numri i nxënësve është 141–175 nxënës.

e) Ndarja e nxënësve në më shumë se pesë klasa paralele vazhdon sipas rregullit të përcaktuar në pikën 2.

B. Numri i drejtuesve

1. Kur numri i nxënësve është 201–400, emërohet një nëndrejtor shkolle.

2. Kur numri i nxënësve është 401–600, emërohen dy nëndrejtorë shkolle.

3. Kur numri i nxënësve mbi 600, emërohen tre nëndrejtorë shkolle.

C. Norma mësimore javore e mësuesve dhe e drejtuesve

1. Mësuesi i gjuhës shqipe dhe i letërsisë: 18 orë në javë.

2. Mësuesi i gjuhës së huaj, i matematikës, i fizikës, i biologjisë, i kimisë, i informatikës, i historisë, i gjeografisë, i teknologjisë, i shkencave shoqërore (filozofi, psikologji, qytetari, sociologji), i ekonomisë: 20 orë në javë.

3. Mësuesi i lëndëve të tjera:

24 orë në javë.

4. Ngarkesa mësimore e mësuesit shoqëruar në piano: 30 orë në javë.

5. Drejtori i shkollës me 81–200 nxënës:

8 orë në javë.

6. Drejtori i shkollës me 201–600 nxënës:

6 orë në javë.



7. Drejtori i shkollës me mbi 600 nxënës:
nuk jep mësim.
8. Nëndrejtori i shkollës me 201–400 nxënës:
8 orë në javë.
9. Nëndrejtori i shkollës me mbi 400 nxënës:
6 orë në javë.

Drejtori dhe nëndrejtorët e shkollës e plotësojnë normën e tyre mësimore javore vetëm me orë të profilit të diplomës që zotërojnë.

Nëndrejtori/nëndrejtorët e shkollës ngarko-hen për amzën dhe inventarin e shkollës kur shkolla nuk ka sekretar.

D. Norma e vlerësimit të arritjeve

1. Drejtori i shkollës me 81–600 nxënës: 4 orë në javë (3 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkollor).
2. Drejtori i shkollës me mbi 600 nxënës: 3 orë në javë (2 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkollor).
3. Nëndrejtori i shkollës: 4 orë në javë (3 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkollor).

E. Organizimi i mësimit në shkollat artistike

1. Orët teorike zhvillohen me të gjithë klasën në lëndët: harmoni, analizë e veprave muzikore, histori e muzikës shqiptare dhe botërore, folklor muzikor, literaturë muzikore, orkestracion, deshifrazh, histori arti, perspektivë, anatomi dhe estetikë.
2. Orët praktike zhvillohen në grupe me 4–5 nxënës në lëndët: harmoni, analizë e veprave muzikore dhe orkestracion.
3. Mësimi individual me 1 nxënës zhvillohet në lëndët: instrumentist, mjeshtëri e të kënduarit dhe piano sekondare.
4. Në lëndën muzikë dhome, mësimi zhvillohet në grupe që formohen me 2–5 nxënës. Në varësi të formacionit dhe të programit mësimor mund të krijohen edhe duete.
5. Shoqërimi i instrumentistëve në saxhio: harqet 8 orë mësimi në vit për nxënës, instrumentet e frymës 6 orë mësimi në vit për nxënës.
6. Në degën e artit figurativ, mësimi zhvillohet në grupe me jo më pak se 8 nxënës në lëndët: vizatim, pikturë, plastikë.
7. Në lëndët e specialiteteve të artit figurativ mësimi zhvillohet në grupe me jo më pak se 4 nxënës.
8. Lënda piano sekondare në shkollat koreografike zhvillohet në grupe me nga 4 nxënës.

V. TË PËRGJITHSHME

1. Mësuesi i arsimit parauniversitar e plotëson normën mësimore javore me lëndë të profilit të tij. Kur nuk ka orë të mjaftueshme në profilin e tij, ai ngarkohet me orë mësimore të profileve të përafërta, sipas shtojcës bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Të gjitha normat e veçanta, të përcaktuara në kreun V të këtij udhëzimi, për efekte financiare kanë vlerën e orës mësimore.

3. Masa e pagesës për orën suplementare bëhet sipas tarifave të orës mësimore suplementare e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Orë suplementare janë orët mësimore të cilat janë realizuar nga mësuesi mbi normën javore të tij.

5. Normë javore është norma mësimore që i ngarkohet mësuesit/drejtuesit për çdo javë të vitit mësimor. Norma javore e mësuesit përfshin orët e mësimit të çdo lënde që përmban plani mësimor dhe çdo orë të përcaktuar në kreun V të këtij udhëzimi.

6. Pagesa e orëve suplementare bëhet në fund të çdo muaji. Drejtoria e shkollës të llogarisë periodikisht pagesat e orëve suplementare, me qëllim që në fund të muajit pagesa e orëve suplementare të përfutur nga mësuesit gjatë muajit përkatës, të jetë në përputhje me orët faktike të realizuara nga mësuesi.

7. Në arsimin fillor, orët suplementare për efekt pagese për mësuesin/kryemësuesin të llogariten mbi normën javore, kur klasa kolektive ka mbi 10 nxënës.

8. Në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë mësuesi nuk lejohet të ketë orë suplementare, më shumë se 30% e normës javore.

9. Puna e mësuesit kujdestar në shkollat e arsimit parauniversitar barasvlerësohet me 2 orë mësimore në javë.

10. Mësuesi që drejton bibliotekën e shkollës dhe punon me librin i llogariten:

- a) 3 orë në javë, kur shkolla ka bibliotekë dhe ka mbi 201–600 nxënës.
- b) 4 orë në javë, kur shkolla ka bibliotekë dhe ka mbi 600 nxënës.

11. Për zhvillimin e veprimtarive konkrete të programuara në kuadër të shkollës si qendër komunitare llogariten 10 orë në javë.

12. Mësuesi që është drejtues i një rrjeti profesional i llogariten 2 orë mësimore në javë.



13. Për zhvillimin e veprimtarive të miratuara në kuadër të nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë”, ora e studimit është e barasvlershme me orën mësimore. Në çdo institucion arsimor të përfshirë në këtë nismë të realizohen jo më shumë se 3 orë studimi në ditë për çdo klasë të krijuar.

14. Mësuesi që merret me veprimtaritë artistike dhe mësuesi që kryen detyrën e koordinatorit të qeverisë së nxënësve për shkollat nën 700 nxënës i llogariten 2 orë në javë dhe për shkollat mbi 700 nxënës i llogariten 4 orë në javë.

15. Mësuesi në shkollat me më shumë se 700 nxënës që kanë palestër, kur krijojnë dhe stërvitin ekupe sportive, jo më shumë se në dy lloje sporti për femra dhe meshkuj, i ulet norma mësimore javore me 3 orë në javë.

16. Mësimi në lëndën e edukimit fizik zhvillohet i ndarë sipas gjinisë dhe kur është e mundur mësuesi të jetë i së njëjtës gjini me nxënësit. Ndarja sipas gjinisë bëhet sipas këtij rregulli:

a) Në institucionet e arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë, kur numri i nxënësve për çdo gjini është jo më pak se 10 nxënës, mësimi i edukimit fizik të bëhet i ndarë në gjini.

b) Në institucionet e arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë që kanë klasa paralele, kur numri i nxënësve për çdo gjini në të paktën një paralel, është më i vogël se 10 nxënës, mësimi i edukimit fizik të bëhet i ndarë në gjini, por duke bashkuar dy paralele.

c) Në institucionet e arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë, që nuk kanë klasa paralele, kur numri i nxënësve për çdo gjini, është më i vogël se 10, mësimi i edukimit fizik të bëhet pa u ndarë në gjini.

17. Për zhvillimin e praktikës në shkollat e mesme të gjuhëve të huaja, të lëndëve të specialitetit në shkollat koreografike dhe teori solfezhi në shkollat e muzikës, kur klasa ka mbi 20 nxënës ndahet në dy grupe.

18. Orët për shoqërimin dhe drejtimin e nxënësve (klasës) në praktikat profesionale mësimore të llogariten 1,5 orë praktikë = 1 orë mësimore.

19. Mësuesve që vlerësojnë testimet e provimeve kombëtare të arsimit bazë, t'u llogaritet për efekt pagese 1 orë mësimore për 3 teste të vlerësuara.

20. Mësuesve që vlerësojnë fazën II të olimpiadave kombëtare të organizuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, t'u llogaritet për efekt pagese 1 orë mësimore për 3 teste të vlerësuara.

21. Në shkollat që nuk kanë as nëndrejtor, as sekretar ngarkohet një mësues për plotësimin e amzës së shkollës, të cilit i ulet norma 2 orë në javë.

22. Mësuesve mentorë, për mentorimin e një praktikanti, t'u ulet 1/4 e normës javore. Një mësues mentoron 1–4 praktikantë. Kur mësuesi mentoron më pak se 4 praktikantë e plotëson normën javore si mësues.

23. Në klasën e dymbëdhjetë të gjimnazit, lëndët me zgjedhje të zhvillohen në bazë të kërkesave të nxënësve.

24. Specialistët që zhvillojnë orë të veçanta në institucionet e arsimit parauniversitar (shkolla), të paguhën vetëm për orët e mësimin që zhvillojnë.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Normat e punës mësimore-edukative dhe numri i nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar, do të jenë si më sipër, duke filluar nga viti shkollor 2018–2019.

2. Udhëzimi nr. 21, datë 23.7.2010, “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”, të ndryshuar, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie ndesh me përcaktimet e këtij udhëzimi, shfuqizohet.

3. Norma mësimore e mësuesve që përfshihen në projekte të ndryshme, si dhe e mësuesit ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara, rregullohet me udhëzime të veçanta.

4. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, njësitë arsimore vendore dhe institucionet arsimore të arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla



SHTOJCË

1. Arsimi parashkollor dhe mësuesit sipas profilit

Nr.	Grupet	Profili i kërkuar	Profili i përafërt
1	Grupi I, II, III	Bachelor për arsimin parashkollor	Bachelor në arsim fillor, e mesme pedagogjike për edukator, shkalla I e kualifikimit (sipas përcaktimeve të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar)

2. Arsimi fillor (klasat I–V) dhe mësuesit sipas profilit

Nr.	Klasat	Profili i kërkuar	Profili i përafërt
1	Klasat I, II, III, IV, V	Arsimi i lartë për arsim fillor	E mesme pedagogjike për mësuesi, shkalla I e kualifikimit (sipas përcaktimeve të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar)

3. Arsimi i mesëm i ulët (klasat VI–IX) dhe mësuesit sipas profilit

Nr.	Lëndët	Profili i kërkuar	Profili i përafërt
1	Gjuhë shqipe	Gjuhë shqipe-letërsi	
2	Gjuhë e huaj	Gjuhë e huaj (anglisht, frëngjisht...)	Gjuhë e huaj; e mesme e gjuhëve të huaja e profilizuar për mësuesi, shkalla I e kualifikimit (sipas përcaktimeve të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar)
3	Matematikë	Matematikë	Matematikë-Fizikë
4	Fizikë	Fizikë	Matematikë-Fizikë
5	Kimi	Kimi	Biokimi, Biologji
6	Biologji	Biologji	Biokimi, Kimi
7	Histori	Histori	Histori-gjeografi, Gjeografi
8	Gjeografi	Gjeografi	Histori-gjeografi, Histori,
9	Qytetari	Shkenca sociale	Histori-gjeografi, Histori, Gjeografi, Gjuhë shqipe-Letërsi
10	Art pamor	Arte figurative	E mesme artistike e profilizuar për mësuesi, shkalla I e kualifikimit (sipas përcaktimeve të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar).
11	Muzikë	Arte muzikore	E mesme e muzikës e profilizuar për mësuesi, shkalla I e kualifikimit sipas përcaktimeve të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar
12	Kërcim	Arti skenik (koreografi)	Mësuesit e arteve (art pamor, muzikë), ose edukim fizik.
13	Teatër	Arti skenik (aktrim, regji)	Mësuesit e arteve (art pamor, muzikë) ose gjuhë shqipe
12	Aftësim teknologjik	Shkencat e natyrës, TIK	Shkencat e natyrës, Informatikë
13	Edukim fizik, sporte dhe shëndeti	Edukim fizik	Mësues i fizkulturës shkalla I e kualifikimit sipas përcaktimeve të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar.
14	TIK	Informatikë, TIK, Matematikë-Informatikë	Matematikë, Fizikë



4. Arsimi i mesëm i lartë dhe mësuesit sipas profilit

a) Kurrikula bërthamë

Nr.	Lëndët	Profili i kërkuar	Profili i përafërt
1	Gjuhë shqipe	Gjuhë shqipe dhe letërsi	
2	Letërsi	Gjuhë shqipe dhe letërsi	
3	Gjuhë e huaj e parë	Gjuhë e huaj (anglisht, frëngjisht...)	
4	Matematikë	Matematikë	Matematikë-Fizikë
5	Fizikë	Fizikë	Matematikë-Fizikë
6	Kimi	Kimi	Biologji-kimi
7	Biologji	Biologji	Biologji-kimi
8	Histori	Histori	Histori-gjeografi
9	Gjeografi	Gjeografi	Histori-gjeografi
10	Qytetari	Shkenca Sociale	Histori-gjeografi
11	Filozofi	Shkenca Sociale	Filozofi
12	Ekonomi	Shkenca Sociale	Ekonomi
13	TIK	Informatikë, TIK, Matematikë-Informatikë	Matematikë
14	Edukimi fizik, sporte dhe shëndeti	Edukim fizik	

b) Kurrikula me zgjedhje

Nr.	Lëndët	Profili i kërkuar	Profili i përafërt
1	Letërsi	Gjuhë shqipe dhe letërsi	
2	Gjuhë e huaj e dytë	Gjuhë e huaj (anglisht, frëngjisht...)	
3	Fizikë	Fizikë	Matematikë-Fizikë
4	Kimi	Kimi	Biokimi
5	Biologji	Biologji	Biokimi
6	Histori	Histori	Histori-gjeografi
7	Gjeografi	Gjeografi	Histori-gjeografi
8	Psikologji	Shkenca sociale	Filozofi, Histori-gjeografi
9	Sociologji	Shkenca sociale	Filozofi, Histori-gjeografi
10	Teknologji	TIK, Fizikë	Shkencat e natyrës, Informatikë, Inxhinieri
11	TIK	Informatikë, TIK, Matematikë-Informatikë	Matematikë
12	Edukimi fizik, sporte dhe shëndeti	Edukim fizik	
13	Arte	Arti skenik, Muzikë, Art figurativ	

**UDHËZIM****Nr. 31, datë 13.9.2018**

**PËR DISA NDRYSHIME NË
UDHËZIMIN NR. 18, DATË 21.5.2018
“PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE
TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E
CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË
PROGRAMET E STUDIMEVE ME
KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË
PROGRAMET E INTEGRUARA TË
CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET
E ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN
AKADEMIK 2018–2019”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, dhe pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”

UDHËZOJ

1. Germat “a” dhe “b”, të pikës 14, të kreut “Kreu IV/3”, të udhëzimit nr. 18, datë 30.7.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ndryshojnë si më poshtë:

“a) Zhvillimi i procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit, të kandidatëve me diploma të huaja të shkollës së mesme, në programet e studimit objekt të këtij udhëzimi, në LAL-të që i zhvillojnë këto programe, si programe të përbashkëta studimi, që përfundojnë me një diplomë të përbashkët, të dyfishtë ose të shumëfishtë, në bashkëpunim me LAL-të e vendeve të BE-së, kryhet sipas afatave dhe procedurave të përcaktuar nga vetë LAL-të.

“b) Njohja e dokumentacionit të kandidatëve të pajisur me diploma të huaja të shkollës së mesme, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre. Pas përfundimit të njohjes, QSHA-ja kryen pajisjen e tyre me NIM dhe brenda muajit janar 2019 ia komunikon zyrtarisht LAL-së.”

2. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, DAR/ZA-të, si dhe IAL-të, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla

UDHËZIM**Nr. 34, datë 10.9.2018**

**PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 45, DATË
19.7.2018 “PËR RATIFIKIMIN E
MARRËVESHJES SË NDRYSHIMIT
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, DUKE VEPRUAR
NËPËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE DHE TRANS ADRIATIK
PIPELINE AG, LIDHUR ME
MARRËVESHJEN ME QEVERINË
E VENDIT PRITËS”**

Në mbështetje të nenit 102, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, të ligjit nr. 45, datë 19.7.2018, “Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me Marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës”, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

1. Importi dhe furnizimi brenda vendit i mallrave dhe shërbimeve në lidhje me aktivitetet e ndërtimit gjatë fazës së ndërtimit të projektit (siç përcaktohet në Marrëveshjen e Qeverisë Pritëse (MQP), e ndryshuar) do t'i nënshtrohet trajtimit të veçantë të TVSH-së, që nënkupton aplikimin e skemës së autongarkesës së TVSH-së (*reverse-charge*) për furnizime të caktuara të mallrave dhe shërbimeve, siç përcaktohet në ligjin nr. 45, datë 19.7.2018, dhe në këtë udhëzim.

2. Për qëllimet e zbatimit të këtij trajtimi të veçantë të TVSH-së, siç përcaktohet në pikën 24.15 të MQP-së, të ndryshuar, Investitori i Projektit do të propozojë deri në 80 kontraktues të nivelit të parë dhe kontraktues të nivelit të dytë (në çdo kohë) dhe do të ketë, gjithashtu, të drejtën që në një fazë të mëvonshme të zëvendësojë çdo kontraktues të nivelit të parë dhe kontraktues të



nivelit të dytë të propozuar. Numri i kontraktuesve të propozuar në çdo periudhë kohore nuk duhet të tejkalojë numrin 80.

- Kontraktuesi i nivelit të parë, nënkupton çdo person dhe filialet e tij sipas kuptimit në ligjin nr. 116/2013, datë 15.4.2013, që furnizojnë mallra dhe/ose shërbime për Investitorin e Projektit, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me kontratë, nënkontratë ose në ndonjë mënyrë tjetër të përcaktuar në legjislacionin shqiptar, por duke përjashtuar çdo individ që vepron në rolin e tij ose të saj si punonjës i ndonjë personi tjetër;

- Kontraktuesi i nivelit të dytë, do të thotë çdo person me të cilin kontraktuesi i nivelit të parë ka një marrëveshje për të kryer detyra specifike në ofrimin e furnizimit të mallrave dhe/ose shërbimeve për Investitorin e Projektit.

2.1 Investitori i Projektit dorëzon propozimin mbi listën fillestare të kontraktuesve në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT), si dhe kopjet e kontratave që Investitori i Projektit ka lidhur me secilin nga kontraktuesit e nivelit të parë së bashku me një kopje të certifikatës së tyre të NIPT-IT/NUIS-it dhe kopjet e kontratave të lidhura midis kontraktuesve të nivelit të parë dhe kontraktuesve të nivelit të dytë.

Investitori i Projektit dorëzon në DPT edhe listën e kontraktuesve të përditësuar herë pas here, bazuar në nevojat e veprimtarisë, derisa numri në listë të arrijë numrin 80 të kontraktuesve, sipas procedurës së paraqitur në paragrafin 2.2 më poshtë. Lista fillestare dhe listat e përditësuara të kontraktuesve të nivelit të parë dorëzohen, gjithashtu, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD).

2.2 Në rast të zëvendësimit ose largimit të kontraktuesve nga lista e kontraktuesve të nivelit të parë dhe të dytë brenda numrit 80, Investitori i Projektit duhet të dorëzojë propozimin mbi listën e kontraktuesve të përditësuar pranë autoriteteve tatimore. Këto ndryshime bëhen efektive tre javë pas dorëzimit të listës së përditësuar të kontraktuesve nga ana e Investitorit të Projektit. Lista do të dorëzohet në DPT dhe DPD, rast pas rasti.

Me bërjen efektive të zëvendësimeve ose largimeve në listën e përditësuar të kontraktuesve, kontraktuesi i çregjistruar nga kjo listë nuk është më subjekt i trajtimit të veçantë të

TVSH-së, të përcaktuar në ligjin nr. 45/2018, por u nënshtrohet dispozitave të përgjithshme të ligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.

Çdo kontraktues i nivelit të parë dhe të dytë i hequr nga lista e kontraktuesve nga Investitori i Projektit mund të ripropozohet dhe të ripërfshihet në listën e kontraktuesve në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 45/2018, dhe këtij udhëzimi.

2.3 Nëse Investitori i Projektit kërkon shtimin e kontraktuesve të rinj, përveç 80 (tetëdhjetë) kontraktuesve të përmendur më sipër, duhet t'i drejtohet Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë DPT-së për të miratuar kontraktuesit e rinj, duke paraqitur një kërkesë të argumentuar mbi nevojën e shtimit të kontraktuesve të rinj dhe duke i bashkëlidhur kësaj kërkesë dhe kopje të kontratës së lidhur mes palëve.

Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT, për dhënien e miratimit, bashkëpunon me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve që administrojnë kontraktuesin e ri. DPT-ja jep një përgjigje për Investitorin e Projektit brenda katër javëve nga paraqitja e kërkesës. Dhënia e miratimit nuk mund të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme.

2.4 Nëse Investitori i Projektit vendos të zëvendësojë një nga kontraktuesit shtesë (mbi numrin 80) me një kontraktues tjetër, ai paraqet një kërkesë, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor pranë DPT-së, për miratimin e zëvendësimit me kontraktuesin e ri. Investitori i Projektit për çdo rast, duhet të paraqesë arsyet për zëvendësimin e kontraktuesit të mëparshëm.

Drejtoria e Kontrollit Tatimor pranë DPT-së, edhe në këtë rast, për dhënien e miratimit bashkëpunon me drejtoritë rajonale të tatimeve që administrojnë kontraktuesin e ri dhe kontraktuesin e zëvendësuar. DPT-ja i kthen përgjigje Investitorit të Projektit brenda katër javëve nga paraqitja e kërkesës. Ky miratim nuk mund të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme. Me bërjen efektive të zëvendësimit në listën e kontraktuesve, kontraktuesi i çregjistruar nga lista e kontraktuesve, nuk është më subjekt i trajtimit të veçantë të TVSH-së, siç është përcaktuar në ligjin nr. 45/2018, por i nënshtrohet dispozitave të përgjithshme të ligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.



3. Për importimin gjatë fazës së ndërtimit të të gjitha makinerive dhe pajisjeve, linjave teknologjike, automjeteve, lëndëve të para, pjesëve të këmbimit dhe çdo malli tjetër që lidhet me projektin, në atë masë që këto importe nuk janë të përjashtuara sipas ligjit të TVSH-së dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, importuesi (Investitori i Projektit/kontraktuesi i nivelit të parë) nuk do të ketë detyrim për pagesën pranë autoriteteve doganore, të tatimit mbi vlerën e shtuar që duhet kryer në lidhje me këto importe. Pra, për importimin e mallrave që nuk janë të përjashtuara në bazë të dispozitave të ligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të tij, do të zbatohet regjimi i veçantë i TVSH-së, i përcaktuar në ligjin nr. 45/2018 dhe në këtë udhëzim. Ky import mallrash do të trajtohet si një furnizim mallrash i kryer nga importuesi për veten e tij, si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike, me efekt lindjen e detyrimit të importuesit për të paguar këtë tatim mbi vlerën e shtuar ndaj administratës tatimore dhe të drejtën e tij për të zbritur këtë tatim mbi vlerën e shtuar.

3.1 Importuesi, në përputhje me paragrafin 3 më sipër, lëshon një faturë tatimore shitjeje për vete, ku do të rezultojë si furnizues dhe blerës i mallrave në të njëjtën kohë (autongarkesë) dhe ka të drejtën që menjëherë të zbresë nga TVSH-ja e llogaritur mbi shitjet që korrespondojnë me këto importe, TVSH-në e zbatuar në këto blerje në të njëjtën vlerë. Pra, nuk do të bëhet një pagesë me para në dorë tek autoritetet tatimore, me kusht që importuesi të ketë të drejtë të zbresë TVSH-në për blerjet sipas dispozitave të përgjithshme të aplikueshme të ligjit të TVSH-së.

Fatura tatimore e përgatitur sipas këtij paragrafi, regjistrohet njëkohësisht në librin e blerjeve dhe shitjeve të TVSH-së. Më konkretisht, vlera e tatueshme dhe TVSH-ja mbi importin do të deklarohen në librin e shitjeve në kolonat [19] dhe [20] “Autongarkesë TVSH-së në shitje (*revers-charge*)”. Fatura e njëjtë do të deklarohet edhe në librin e blerjeve në kolonat [38] dhe [39] “Autongarkesë e TVSH-së në blerje me të drejtë kreditimi (*reverse-charge*)”.

Gjithashtu, për qëllimin e vetëm të deklarimit të importit, dokumenti i vetëm administrativ përkatës do të deklarohet në librin e blerjes në kolonën “Importe të përjashtuara të investimit pa

TVSH” me ngjyrë të kuqe, por nuk do të merret në konsideratë kur të llogariten blerjet e Investitorit të Projektit ose kontraktuesit të nivelit të parë.

3.2 Investitorit të Projektit apo kontraktuesit të nivelit të parë i lëshohet deklarata doganore (DAV) e importit (IM4), me një numër regjistrimi R. Një kod plotësues (për trajtimin e veçantë të TVSH-së sipas ligjit nr. 45/2018), shtohet në kutinë nr. 37 të DAV-së. Në kutinë nr. 47 (llogaritja e detyrimeve) të DAV, kolona MP, në zërin TVSH shënohet një numër i veçantë nga administrata doganore, që nënkupton mospagesën e TVSH-së në momentin e importit. Prandaj, në totalin e detyrimeve që duhet paguar, paraqitet vetëm shuma e detyrimeve doganore.

Në momentin e importit, për çdo regjistrim, do të shprehet qartë “Importi sipas trajtimit të veçantë të TVSH-së në përputhje me ligjin nr. 45/2018, referuar deklaratës doganore nr. ____ , datë ____”.

3.3 Kontraktuesi i nivelit të parë ose Investitori i Projektit sipas këtij udhëzimi, për importin e parë të kryer do të dorëzojë pranë autoriteteve doganore:

- a) Një kërkesë me shkrim për zbatimin e dispozitave të këtij udhëzimi;
- b) Një kopje të certifikatës së NIPT/NUIS-it;
- c) Një kopje të kontratës së lidhur me Investitorin e Projektit, ku jepen detaje mbi mallrat, sasitë dhe degët e kontraktuesve të nivelit të parë që do të furnizojnë mallrat për t'u importuar.

3.4. Trajtimi i importeve, siç përcaktohet më sipër në paragrafët 3 deri në 3.3, nuk ndikon në të drejtën e importuesit për të zbritur TVSH-në për blerjet (mbi bazën e autongarkesës, të lëshuar siç është paraqitur në paragrafin 3.1 më sipër) njësoj sikur importi i kryer nga ai të ishte një importim i tatueshëm sipas dispozitave të përgjithshme të ligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.

4. Për sa u përket furnizimeve brenda vendit të mallrave dhe shërbimeve të kryera të lidhura me projektin dhe të kryera gjatë fazës së ndërtimit nga kontraktuesit e nivelit të parë dhe kontraktuesit e nivelit të dytë, vetëm personi për të cilin kryhen furnizimet, do të jetë përgjegjës për deklarimin si të pagueshëm tek autoritetet



tatimore të çdo detyrimi TVSH-je dhe do të ketë të drejtë për të zbritur këtë TVSH përmes skemës së autongarkesës (*reverse-charge*), në përputhje me dispozitat e përgjithshme të ligjit të zbatueshëm të TVSH-së. Në këtë rast, në faturat e lëshuara nga furnizuesi për furnizimet, nuk llogaritet dhe pasqyrohet TVSH-ja. Një trajtim i tillë i furnizimeve nuk do të ndikojë në të drejtën e furnizuesit për të zbritur TVSH-në për blerjet, në mënyrë të njëjtë sikur furnizimi i kryer nga ai të ishte një furnizim i tatueshëm sipas dispozitave të përgjithshme të ligjit të TVSH-së.

Kjo procedurë është e zbatueshme vetëm për furnizime të kryera nga kontraktorët e nivelit 1 dhe kontraktorët e nivelit 2.

4.1 Marrësi i këtyre furnizimeve, që sipas rastit do të jetë Investitori i Projektit ose kontraktuesi i nivelit të parë, do të lëshojë një faturë tatimore shitjeje për veten e tij ku do të rezultojë si furnizues (shitës) dhe marrës (blerës) i mallrave dhe shërbimeve në të njëjtën kohë (autongarkesë) dhe ka të drejtën të zbresë menjëherë nga TVSH-ja e llogaritur mbi shitjet që i korrespondojnë këtyre furnizimeve të mallrave ose shërbimeve, TVSH-në e zbatuar në këto blerje, në të njëjtën vlerë, pra nuk do të bëhet pagesë në administratën tatimore, me kusht që personi të cilit i janë kryer furnizimet të ketë të drejtën të zbresë këtë TVSH në blerje, sipas dispozitave të përgjithshme të ligjit të TVSH-së.

4.2 Furnizimet e kryera ndërmjet një pale të tretë dhe një kontraktuesi të nivelit të dytë kur ky i fundit është marrësi i mallrave ose shërbimeve dhe pavarësisht nëse ato janë të lidhura me aktivitetet e ndërtimit gjatë fazës së ndërtimit të projektit, nuk i nënshtrohen trajtimit të veçantë të TVSH-së sipas këtij udhëzimi. Këto furnizime u nënshtrohen dispozitave të përgjithshme të ligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

4.3 Për furnizimet e kryera nga kontraktuesi i nivelit të dytë te kontraktuesi i nivelit të parë, kontraktuesi i nivelit të dytë do të lëshojë një faturë tatimore, pa llogaritur apo deklaruar TVSH-në në faturë, pasi furnizimet e kryera nga kontraktuesi i nivelit të dytë janë të tatueshme me TVSH, por detyrimin për të llogaritur, deklaruar dhe paguar TVSH-në për këto furnizime e mban përfituesi (blerësi) i këtyre furnizimeve. Kontraktuesi i nivelit të dytë do të regjistrojë

faturat e shitjes në librin e shitjeve në kolonën “Shitje pa TVSH”.

4.4 Për vlerën e furnizimeve të kryera nga kontraktuesi i nivelit të dytë, sipas faturës së lëshuar në përputhje me paragrafin 4.3, kontraktuesi i nivelit të parë do të lëshojë një faturë tatimore shitjeje për vete, kur ai do të rezultojë si furnizues (shitës) dhe marrës (blerës) i mallrave dhe shërbimeve në të njëjtën kohë (autongarkesë). Kontraktuesi i nivelit të parë do të deklarojë në librin e blerjes respektivisht në kolonat [38] dhe [39] “Autongarkesë e TVSH-së në blerje me të drejtë kreditimi (*reversë-charge*)”, vlerën e tatueshme dhe TVSH-në e paraqitur në këtë faturë, me kusht që kontraktuesi i nivelit të parë të ketë të drejtën të zbresë këtë TVSH për blerjet sipas dispozitave të përgjithshme të ligjit të zbatueshëm të TVSH-së. Në të njëjtën kohë, vlera e tatueshme dhe TVSH-ja do të deklarohen në librin e shitjeve në kolonat [19] dhe [20] “Autongarkesë TVSH-së në shitje (*reversë-charge*)”.

4.5 Fatura tatimore e lëshuar nga kontraktuesi i nivelit të dytë do të regjistrohet dhe deklarohet në librin e blerjeve të kontraktuesit të nivelit të parë në kolonën [25] “Blerje investimi brenda vendit pa TVSH”, me ngjyrë të kuqe, vetëm për qëllime të evidentimit dhe rakordimit nga administrata tatimore, por nuk do të merren parasysh për qëllimet e llogaritjes së blerjeve të përgjithshme të kontraktuesit të nivelit të parë.

4.6 E njëjta procedurë do të zbatohet nga kontraktuesi i nivelit të parë që furnizon mallra dhe/ose shërbime në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për Investitorin e Projektit. TVSH-ja nuk do të llogaritet dhe faturohet në faturën tatimore të lëshuar nga kontraktuesi i nivelit të parë tek Investitori i Projektit. Kontraktuesi i nivelit të parë do ta deklarojë këtë faturë në librin e shitjeve në kolonën “Shitje pa TVSH”. Investitori i Projektit do të lëshojë një faturë shitjeje për vete (autongarkesë), e cila do të deklarohet në librat e TVSH-së, siç është paraqitur në paragrafin 4.4 më sipër.

4.7 Trajtimi i furnizimeve siç përcaktohet në paragrafët 4.1 deri 4.6, nuk ndikon në të drejtën e furnizuesit për të zbritur TVSH-në për blerjet në mënyrë të njëjtë sikur këto furnizime të ishin furnizime të tatueshme me TVSH sipas dispozitave të përgjithshme të ligjit të TVSH-së.



5. Faturat saktësuese (nota e kreditit/nota e debitit) të lëshuara në përputhje me nenin 41 të ligjit të TVSH-së do të trajtohen në të njëjtën mënyrë dhe procedurë si fatura për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të përmendura në paragrafët 3 dhe 4, të këtij udhëzimi. Faturat e lëshuara në përputhje me nenin 97, të ligjit të TVSH-së, për pagesa të arkëtuara përpara se të kryhet furnizimi i mallit ose përpara përfundimit të furnizimit të shërbimit, do të trajtohet në të njëjtën mënyrë dhe procedurë si fatura për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të përmendura në paragrafët 4 të këtij udhëzimi.

6. Nëse Investitori i Projektit, kontraktuesi i nivelit të parë ose kontraktuesi i nivelit të dytë kryejnë furnizime mallrash ose shërbimesh për palë të treta për të cilat nuk zbatohet i veçantë i TVSH-së (*reverse-charge*), siç përcaktohet në këtë udhëzim, ata do të lëshojnë një faturë tatimore në përputhje me dispozitat e përgjithshme të ligjit të TVSH-së.

7. Nëse furnizimet brenda vendit të mallrave ose shërbimeve të kryera nga kontraktuesi i nivelit të parë ose kontraktuesi i nivelit të dytë, janë të përjashtuara nga TVSH-ja në bazë të dispozitave të përgjithshme të ligjit të TVSH-së, atëherë dispozitat e këtij udhëzimi nuk zbatohen për këto furnizime, që do të thotë se këto furnizime nuk do të t'i nënshtrohen skemës së autongarkesës nga marrësi i furnizimit.

Gjithashtu, llojet e furnizimeve të mallrave dhe shërbimeve, të cilat furnizohen prej kontraktuesve të nivelit të parë dhe të dytë duke mos aplikuar TVSH sipas trajtimit të veçantë të kësaj skeme, nuk duhet të merren (blihen) jashtë kushteve dhe kriterëve të kësaj skeme, duke u ngarkuar me TVSH jo në përputhje me kriteret dhe kushtet e parashikuara në këtë udhëzim.

8. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për marrjen e masave për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Arben Ahmetaj

UDHËZIM

Nr. 35, datë 10.9.2018

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS PËR PËRZGJEDHJEN E ZHVILLUESIT NË ZONËN E TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK NË PROCEDURËN ME APLIKIM, NË PRONË PRIVATE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës dhe pika 4, e nenit 14, të VKM-së nr. 646, datë 22.7.2015 “Për përcaktimin e procedurave e të kriterëve të përzgjedhjes së zhvilluesit në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, ministri përgjegjës për ekonominë

UDHËZON:

1. Ministria përgjegjëse për ekonominë është përgjegjëse për përzgjedhjen e zhvilluesit në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në procedurën me aplikim, në pronë private.

2. Kandidati zhvillues aplikon pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë, duke paraqitur studimin në lidhje me projektin, i cili duhet të përqendrohet në:

- a) Përshkrimin e përgjithshëm të projektit;
- b) Përfitimet strategjike dhe operacionale që priten nga projekti;
- c) Vlerësimet paraprake të kostos së projektit, vlera e investimit;
- d) Llojet e veprimtarisë që do të kryhen në zonë, për të cilat duhet të mbahet parasysh nxitja e industrive të reja, teknologjive novatore, teknologjive të informacionit, industrive që përmbushin standardet ndërkombëtare të eliminimit të ndotjes, industrive eficiente në përdorimin e energjisë, si dhe industrive me produktivitet të lartë, në raport me punonjësit;
- e) Numri i të punësuarve etj.

3. Në rastin kur projekti do të realizohet në pasurinë në pronësi të subjektit kandidat për zhvillues, nga ana e tij duhet të dorëzohet përshkrimi i pronës private, vendndodhja e saj, dokumenti i pronësisë, statusi juridik aktual i pasurisë i lëshuar nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, i shoqëruar me hartën treguese të pasurisë.

4. Në rast se projekti do të realizohet në pasurinë me statusin pronë private, jo në pronësi të subjektit kandidat për zhvillues, kandidati për



zhvillues së bashku me dokumentacionin sipas pikës 3, duhet të dorëzojë edhe aktmarrëveshjen paraprake, të lidhur ndërmjet kandidatit për zhvillues dhe pronarit të pasurisë.

5. Drejtoria e Administrimit të Pronës Shtetërore, Sektori i Zonave Ekonomike, bën vlerësimin paraprak të studimit të paraqitur, në mënyrë që të përcaktojë nëse:

a) Objektivat e projektit i shërbejnë interesit publik dhe përshtaten me strategjitë sektoriale apo rajonale të zhvillimit;

b) Nuk ka kufizime për zbatimin e projektit;

c) Projekti mund të zbatohet siç është planifikuar, duke përdorur teknologjitë e propozuara dhe pa rreziqe të arsyeshme teknike;

d) Projekti siguron përshpejtimin e zhvillimit rajonal;

dh) Drejtoria e Administrimit të Pronës Shtetërore, Sektori i Zonave Ekonomike, kërkon informacion nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për statusin aktual të pasurisë, në të cilën do të ndërtohet zona, të shoqëruar me dokumentacionin ligjor dhe hartografik të pasurisë (kartelë + hartë treguese).

6. Pas kryerjes së vlerësimit paraprak, ministria përgjegjëse për ekonominë bazuar në informacionin, konkluzionet, si dhe rekomandimet e siguruar nga dokumenti i vlerësimit paraprak, mund të shprehet për pranueshmërinë e aplikimit, ose të ndërpresë studimin dhe të shtyjë ose të refuzojë plotësisht zbatimin e projektit. Bazat për ndërprerjen mund të përbëhen nga provat thelbësore të mungesës së mundshme të fizibilitetit të projektit/alternativave që janë analizuar. Prova të tilla krijohen në bazë të krahasimeve paraprake të përfitimeve dhe kostove, të informacionit mbi mungesën e fizibilitetit/përshtatshmërisë financiare apo të konkluzionit se objekti në përgjithësi nuk është i nevojshëm.

7. Nëse aplikimi vlerësohet i pranueshëm, i kërkohej kandidatit për zhvillues të paraqesë pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë të gjithë dokumentacionin, për plotësimin e kriterëve kualifikues dhe vlerësuese sa më poshtë:

I. KRITERET PËR KUALIFIKIM:

A. Kriteret administrative-ligjore:

a) Çdo kandidat/ofertues të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm:

i. certifikatën e regjistrimit dhe certifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKB;

ii. vërtetim që subjekti nuk është në proces falimentimi dhe kapitalet e tij nuk janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit;

iii. vërtetim që subjekti nuk është në procedura për deklarimin e falimentimit dhe nuk ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose nuk ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedure tjetër të ngjashme;

iv. vërtetim nga institucionet përkatëse që nuk është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

v. vërtetim që ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve dhe për detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore.

Kërkesat e nënplikave “i-iv” plotësohen me dorëzimin e ekstraktit të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit, si dhe ekstraktin mbi historikun e subjektit, të lëshuara nga Qendra Kombëtare Biznesit dhe me vërtetime nga institucionet përgjegjëse për lëshimin e këtyre dokumenteve.

Kërkesat e nënplikave “v” plotësohen me dorëzimin e vërtetimit të lëshuar nga administrata tatimore.

ç) Kandidati/ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Nëse dokumentet e sipërpërmendura nuk lëshohen në shtetin e origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim nga ana e kandidatit/ofertuesit.

B. Kriteret teknike:

Në rastet kur ndërtimi i zonës do të bëhet nga vetë kandidati për zhvillues, nga ana e tij duhet të plotësojë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Punime të ngjashme të realizuara dhe të përfunduara me sukses;

b) Licencat profesionale që lidhen me ekzekutimin e punimeve sipas objektit të kontratës;

c) Kualifikimet arsimore dhe profesionale të stafit përgjegjës për drejtimin e punimeve. Një listë të personelit të nevojshëm për zbatimin e kontratës, e shoqëruar kjo me CV-të e stafit, licencat profesionale ose dokumente të tjera provuese;

ç) Kandidati për zhvillues duhet të paraqesë deklaratë mbi numrin e fuqisë punëtore për dy vitet e fundit;



d) Kandidati për zhvillues duhet të paraqesë deklaratë të mjeteve, pajisjeve teknike që mund të vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën.

Në rastin kur ndërtimi i zonës do të bëhet me kompani nënkontraktore, atëherë kandidati për zhvillues do të dorëzojë aktmarrëveshjen me kompaninë që merr përsipër ndërtimin e zonës dhe pikat e mësipërme do të plotësohen nga kompania nënkontraktore.

C. Kriteret financiare:

a) Kopje të certifikuara të bilanceve të vitit të fundit ushtrimor dhe raportet e auditit financiar, të certifikuara nga një subjekt i licencuar auditimi. Bilanci të jetë i shoqëruar me vulën ose vërtetimin e dorëzimit pranë autoriteteve përkatëse;

b) Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të vitit të fundit ushtrimor, të lëshuar nga institucionet kompetente.

II. KRITERET PËR VLERËSIM:

A. Kriteret teknike në lidhje me organizimin dhe funksionimin e brendshëm të zonës:

a) Propozimin e projektit teknik, i cili duhet të përmbajë:

- projektidenë;
- të dhëna për teknologjinë e përdorur;
- të dhëna për cilësinë e infrastrukturës dhe vlerat e investimit;
- planin teknik dhe inxhinierik të zonës në përputhje me standardet e përdorura për ndërtim dhe planifikimin urban;
- planin e zbatimit, planin operacional dhe metodat për funksionimin dhe mirëmbajtjen e zonës;

- programin për tërheqjen e industrive të reja;
- llojin e aktiviteteve ekonomike në zonë.

B. Kriteret në lidhje me ndikimin mjedisor:

a) Impakti mjedisor i investimeve dhe funksionimit të zonës;

b) Lloji i aktivitetit duke u bazuar te studimet mjedisore të zonës.

C. Kriteret në lidhje me ndikimin social:

- a) Numri i të punësuarve;
- b) Programi për përgjegjësinë sociale;
- c) Trajnimi i punonjësve dhe transferimi i teknologjisë;
- ç) Lidhjet me ekonominë vendase jashtë zonës.

D. Kohëzgjatja e punimeve:

a) Grafiku, fazat dhe afatet e ekzekutimit të investimeve për zhvillimin e zonës.

E. Kriteret në lidhje me kapacitetin financiar të kompanisë dhe me mundësinë e financimit të projektit:

a) Propozimin e planbiznesit, i cili duhet të përmbajë:

- Shpenzimet kapitale për kryerjen e investimit në zonë;
- Shpenzimet për kostot operationale dhe të ardhurat;
- Garanci bankare për kapitalin e nevojshëm financiar për kryerjen e investimit në zonë.

8. Në rast se kandidati për zhvillues është bashkim operatorësh, do të dorëzojë një marrëveshje, e cila do të jetë e noterizuar, ku të jenë përcaktuar përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit dhe elementët konkretë që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi, e cila nuk mund të jetë më pak se 11% dhe operatori drejtues i grupit nuk mund të ketë më pak se 35%.

9. Në qoftë se do të kemi bashkim operatorësh, kërkesat administrativo-ligjore dhe financiare duhet të plotësohen nga secili operator më vete. Ndërsa kërkesat teknike do të plotësohen nga të gjithë operatorët të marrë së bashku.

10. Ministri përgjegjës për ekonominë, mbasi është paraqitur dokumentacioni i kërkuar në pikën 7 të udhëzimit, nxjerr urdhrin për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Projektit, i cili përbëhet jo më pak se 5 persona, specialistë të fushës përkatëse të ministrisë përgjegjëse për ekonominë dhe sipas rastit, nga përfaqësues të ministrive apo të institucioneve të tjera, të cilët gjykojnë që kanë lidhje me aktivitetin që do të kryhet në zonë. Në çdo rast, numri i anëtarëve duhet të jetë tek. Lejohet edhe kontraktimi i ekspertëve të përkohshëm që mund të jenë pjesë e grupit të punës për vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati për zhvillues. Shpenzimet për ekspertët e përkohshëm përballohen nga kandidati për zhvillues.

11. Komisioni brenda 60 ditëve të ngritjes bën vlerësimin e projektit dhe përgatit një raport përmbledhës, ku shprehet për pranimin ose jo të projektit për shpalljen e Zonës së Teknologjisë



dhe Zhvillimit Ekonomik dhe miratimin e Zhvilluesit, të cilën ia propozon titullarit të ministrisë përgjegjëse për ekonominë. Komisioni kur nuk ka mundur të bëjë vlerësimin e projektit për arsye të kompleksitetit të tij, mund të kërkojë zgjatjen e afatit për aq sa është e nevojshme për përfundimin e vlerësimit, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.

12. Ministrit përgjegjës për ekonominë në bazë të raportit përmbledhës, miraton shpalljen e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik dhe zhvilluesin e saj.

13. Në përputhje me nenin 4 të ligjit, ministria përgjegjëse për ekonominë i propozon Këshillit të Ministrave shpalljen e zonës dhe zhvilluesin e saj.

14. Ministri përgjegjës për ekonominë urdhëron ngritjen e grupi të negocimit të kontratës në përbërjen e të cilit janë përfaqësues të ministrive dhe institucioneve që kanë lidhje me aktivitetin e kësaj zone dhe nga Avokati i Shtetit, pas publikimit në Qendrën e Publikimeve Zyrtare të vendimit të Këshillit të Ministrave.

15. Ministri përgjegjës për ekonominë do të ftojë zhvilluesin të fillojë procedurat e negocimit të kontratës, menjëherë pasi ai të ketë dorëzuar “Formulari i sigurimit të kontratës”, në formën e një depozite ose e bankare të pakushtëzuar, në masën 1% të vlerës së investimit.

16. Gjatë ekzekutimit të kontratës, nëse janë parashikuar faza për zbatimin e projektit, sipas grafikut të punimeve të propozuar në ofertë, kontraktori mund të kërkojë parashikimin e reduktimit të përqindjes së vlerës së sigurimit në mënyrë përpjesëtimore, por jo më pak se 25% të vlerës korresponduese të sigurimit të kontratës.

17. Procedurat e negocimit përfundojnë jo më vonë se 90 (nëntëdhjetë) ditë nga data e këtij publikimi. Grupi i negocimit mund të kërkojë shtyrjen e afatit të negocimit të kontratës, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.

18. Miratimi i kontratës bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Arben Ahmetaj

UDHËZIM

Nr. 634, datë 14.9.2018

PËR NDRYSHIMIN E UDHËZIMIT NR. 3909/1, DATË 4.10.2016, “MBI PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE, PROCEDURAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE NË UJËRAT DETARE NËN JURIDIKSIONIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 18, të ligjit nr. 10109, datë 2.4.2009, “Për administratën detare të Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar, me qëllim rregullimin e veprimtarisë së transportit kombëtar detar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 3909/1, datë 4.10.2016, “Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave për ushtrimin e veprimtarive në ujërat detare nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë”, pika 7, “Rregullorja nuk përfshin mjetet lundruese”, germa “g”, ndryshon si më poshtë:

“g) mjetet e angazhuara në veprimtari kërkimore-shkencore ose veprimtari të përkohshme që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në nenin 82, të Kodit Detar, që kryhen në zbatim të një marrëveshjeje dy- apo shumëpalëshe, ku njëra palë është qeveria shqiptare, institucioni shtetëror qendror apo autoritetet e tjera përkatëse, leja e të cilave jepet nga autoriteti kompetent sipas legjislacionit në fuqi pas kërkesës së dërguar nga pala e interesuar.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Damian Gjijnuri

**URDHËR****Nr. 582, datë 17.9.2018**

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN
NR. 185, DATË 19.4.2018, “PËR
NGRITJEN E TRI QENDRAVE
RAJONALE RINORE”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 377, datë 11.6.2014, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Shërbimit Kombëtar për Rininë”,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 185, datë 19.4.2018, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja “b” e pikës 1, ndryshohet si më poshtë:

“b) në qytetin e Lushnjës, qarku Fier.”.

b) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Organika e qendrave rajonale rinore, Lezhë, Lushnjë dhe Elbasan të jetë sipas lidhjes

1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.”.

c) Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Numri i punonjësve për qendrat rajonale rinore, Lezhë, Lushnjë dhe Elbasan, të jetë gjithsej 12 veta.”.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Shërbimi Kombëtar për Rininë dhe qendrat rinore.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla

Lidhja 1

**ORGANIKA E QENDRAVE RINORE NË QARKUN LEZHË (QYTETI LAÇ), QYTETI
LUSHNJË (QARKU FIER), QARKU ELBASAN (QYTETI ELBASAN)**

Pozicioni	Kategoria	Numri
Titullari i institucionit rajonal	III-B	1
Specialist	IV-B	3

Punonjës gjithsej për secilën qendër _____ 4

Punonjës gjithsej për tri qendrat rajonale _____ 12

**URDHËR****Nr. 214, datë 14.9.2018****PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM
TË KOMPETENCAVE**

Në zbatim të nenit 28 dhe nenit 29, të Kodit të Procedurave Administrative, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 58, datë 29.1.2004, “Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, të nenit 26 të rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.2015, “Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me përjashtim të kompetencave, të cilat nuk delegohen dhe që janë të shprehur me ligj, drejtorit të Drejtorisë së Sigurimit, Administrimit të Dokumenteve dhe Regjistrit Qendror, z. Agron Cani.

2. Ndër të tjera, z. Cani ngarkohet edhe me:

- Ndjekjen e detyrave të vendosura në planin mujor të muajit shtator 2018;

- Ndjekjen dhe zbatimin e “Rregullores për funksionimin dhe organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, të ndryshuar.

3. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të titullarit, në funksion të Kontrollit të Figurës së Subjekteve të Rivlerësimit, përgjegjësit të Sektorit për Kontrollin e Figurës së Subjekteve të Rivlerësimit, z. Adhurim Hasanaj.

4. Z. Adhurim Hasanaj i delegohen kompetencat si më poshtë:

a) Mbikëqyr dhe udhëzon grupin e punës për Kontrollin e Figurës së Subjekteve të Rivlerësimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij;

b) Përfaqëson grupin e punës në marrëdhëniet me:

- Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK);

- Kolegjin e Apelimit (KA) dhe Komisionerët Publikë;

- Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM);

c) Organizon dhe drejton veprimtarinë e grupit të punës;

ç) Kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për realizimin e qëllimit, objektit dhe detyrave për të cilat është ngritur grupi i punës.

5. Mbledhjet e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar (KDZH) do të mbledhen sipas nevojës së procesit të rivlerësimit kalimtar nga nënkryetari i KDZH-së, në përputhje me vendimin nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”.

6. Kompetencat e mësipërme delegohen për periudhën 17.9.2018 deri 20.9.2018.

7. Z. Cani dhe z. Hasanaj nuk mund t'i nëndelegojnë këto kompetenca.

8. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Drejtorisë së Sigurimit, Administrimit të Dokumenteve dhe Regjistrit Qendror.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

10. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**DREJTOR
Dorian Tola**

UDHËZIM**Nr. 47, datë 14.9.2018****PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
PËR RUAJTJEN E SIGURISË SË TË
DHËNAVE PERSONALE TË
PËRPUNUARA NGA SUBJEKTET
PËRPUNUESE TË MËDHA**

Në mbështetje të shkronjës “P”, pika 1, të nenit 31 dhe të nenit 27, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”),

UDHËZON:

1. Përcaktimin e masave të sigurisë teknike, organizative edhe në lidhje me personelin, për mbrojtjen e të dhënave personale të përpunuara



nga subjektet përpunuese të mëdha, më poshtë referuar subjektet përpunuese të të dhënave personale, si dhe rregullat e bashkëpunimit të tyre me Komisionerin.

2. Për qëllime të këtij udhëzimi, përkufizimet e mëposhtme kanë këto kuptime:

a) “Subjekte përpunuese të mëdha” janë kontrolluesit ose përpunuesit të cilët përpunojnë të dhëna personale në mënyrë elektronike ose manuale, duke shfrytëzuar 6 e më shumë persona për të kryer përpunimin, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me anë të përpunuesve;

b) “Raport vlerësimi” është raporti i rezultateve të kontrollit të fundit të sigurisë në sistemin e arkivimit;

c) “Politika e Sigurisë së Informacionit” (më poshtë referuar “PSI”) është dokumenti me anë të të cilit subjekti përpunues i të dhënave u komunikon punonjësve të tij dhe kontraktorëve (përpunuesve) mënyrën e ndërtimit, zbatimit dhe operimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (më poshtë referuar “SMSI”) për mbrojtjen e të dhënave;

ç) “Person i kontaktit” është ai të cilit subjekti përpunues i ka dhënë akses në të dhënat personale.

3. Kategoritë kryesore të përdoruesve, që detyrohen të ruajnë sigurinë e të dhënave personale, janë:

a) Administratorët e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, Komunikimit (më tej të quajtur “TIK”) dhe të sigurisë së tyre, të cilët zbatojnë këtë detyrim, kur subjekti i cili përpunon të dhëna personale ka një sistem TIK të brendshëm dhe/ose të jashtëm të instaluar për të përmbushur këtë qëllim.

b) Operatorët e të dhënave personale (të punësuarit, të kontraktuarit etj.), të cilët përpunojnë të dhëna personale, me qëllim përmbushjen e detyrave të tyre kur punojnë për subjektin përpunues të të dhënave personale.

c) Të gjithë personat e caktuar nga subjekti përpunues për të përpunuar të dhënat në mënyrë manuale.

4. Përveç sa parashikohet në udhëzimin për detyrimet e kontrolluesve, përpara se të përpunojnë të dhënat personale, subjektet përpunuese duhet të përpunojnë të dhënat personale në përputhje me rregullat e përcaktuara edhe në këtë udhëzim.

5. Dispozitat në lidhje me sigurinë e sistemit TIK janë të detyrueshme për ato subjekte që

përpunojnë të dhëna personale në mënyrë elektronike. Për ato që përpunojnë të dhëna personale në mënyrë manuale do të zbatohen vetëm dispozitat përkatëse për sigurinë fizike, sigurinë e ambientit dhe të personelit.

6. Komisioneri, në çdo kohë, mund t’i kërkojë subjektit përpunues të të dhënave personale të provojë nivelin dhe përmbajtjen e masave të sigurisë teknike, organizative edhe në lidhje me personelin me anë të një raporti vlerësimi. Raporti i vlerësimit duhet të jetë hartuar nga subjekti përpunues jo më tepër se dy vjet përpara kërkesës së Komisionerit. Subjektet përpunuese duhet të paraqesin, brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga dita e kërkesës, raportin e vlerësimit. Nëse vlerësimi nuk paraqitet në afat, Komisioneri i kërkon subjektit përpunues të të dhënave personale që me shpenzimet e tij të kryejë një kontroll të ri dhe të dorëzojë raportin e vlerësimit brenda tre muajve.

7. Kontrolli i sigurisë së sistemit të përpunimit të të dhënave mund të kryhet vetëm nga një auditues i pavarur dhe i paanshëm, si dhe profesionalisht i kualifikuar, i cili nuk ka marrë pjesë në zhvillimin, zbatimin dhe drejtimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit të sistemit të arkivimit.

KAPITULLI I SISTEMI I MENAXHIMIT TË SIGURISË SË INFORMACIONIT (SMSI) PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE

8. Krijimi dhe mirëmbajtja e SMSI-së për mbrojtjen e të dhënave personale është i detyrueshëm për të gjitha subjektet përpunuese. Ky sistem bazohet në identifikimin, analizimin dhe në zbutjen e rreziqeve ndaj sigurisë së të dhënave personale, duke marrë parasysh dobësitë e:

a) Sistemeve TIK të përdorura për përpunimin e të dhënave personale;

b) Të gjitha formave manuale të përpunimit të të dhënave personale;

c) Sigurisë fizike, brenda dhe jashtë ambienteve, sigurisë së personelit dhe pajisjeve elektronike ose të lëvizshme.

9. Në rast se kontrolluesi përdor më shumë se një përpunues, çdo përpunues duhet të ketë vënë në zbatim një SMSI. Ndarja e përgjegjësive për mbrojtjen e të dhënave personale ndërmjet palëve duhet të shprehet qartë në dokumentacionin që rregullon marrëdhëniet e tyre kontraktore. Të gjitha



këto kërkesa do të përmbushen pa cenuar marrëdhënien kontraktore të delegimit (*outsourcing*). Kur kontrolluesi përdor një përpunues, atij do t'i komunikohen vetëm pjesët e zbatueshme për SMSI-në, të cilat do të jenë ligjërish të detyrueshme në një kontratë për përpunimin e të dhënave.

10. SMSI-ja do të përcaktohet duke marrë parasysh standardet e sigurisë së informacionit, si më poshtë:

a) “Konfidencialitetin”, duke siguruar që të dhënat të jenë të aksesueshme vetëm për personat e autorizuar;

b) “Integritetin”, duke siguruar që të dhënat të jenë të sakta, të plota dhe duke ruajtur metodat e përpunimit të tyre;

c) “Disponueshmërinë”, duke siguruar aksesin e përdoruesit të autorizuar në të dhënat dhe në sistemet e përpunimit;

ç) “Besueshmërinë” e sistemeve TIK që janë përdorur për përpunimin e të dhënave dhe të personelit që i ka përdorur ato, duke garantuar që çdo aktivitet/veprim i tyre mbi të dhënat është i gjurmueshëm dhe i kontrollueshëm.

11. SMSI-të do të përfshijnë, në veçanti:

a) Analizën e Ndikimit në të Dhënat Personale. Përpara përpunimit të të dhënave personale, kontrolluesi ose përpunuesi duhet të kryejë një vlerësim të ndikimit të operacioneve të përpunimit që janë parashikuar në mbrojtjen e të dhënave personale, duke evidentuar se ku këto operacione përpunimi mund të paraqesin rreziqe të veçanta ndaj të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave, për shkak të natyrës, shtrirjes ose qëllimit të tyre;

b) Politikën e Sigurisë së Informacionit, përfshirë sigurinë e përpunimit të të dhënave personale;

c) Kontrollin e sigurisë së sistemit të arkivimit të të dhënave personale;

ç) Udhëzime të detajuara të sigurisë që mbulojnë fushat specifike;

d) Sigurinë fizike brenda dhe jashtë ambienteve;

dh) Sigurinë e personelit dhe pajisjeve elektronike të lëvizshme ose jo.

12. SMSI-ja duhet të funksionojë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, standardet teknike për sistemet e sigurisë së TIK-ut, rregullat e praktikës së mirë në fushën e sigurisë së informacionit, dhe rekomandimet e hartuara nga organizata industriale profesionale, përfshirë

bankat, telekomunikacionet, siguracionet, sigurimet shoqërore dhe kujdesin shëndetësor. SMSI-ja duhet të jetë e përshtatur me nivelin e rreziqeve dhe dobësitë e sistemeve të përpunimit të të dhënave personale.

13. Në rast se përpunimi i të dhënave kryhet me anë të shërbimeve *cloud computing* ose me anë të përpunimit të lëvizshëm, do të zbatohen masa sigurie shtesë (p.sh., aktivizimi i shërbimit kundër vjedhjes në kompjuterin portabël ose në telefonin *smart*). Të gjitha pajisjet që shërbejnë si mbartës të dhënash do të kodohen.

Ruajtja e të dhënave në këto shërbime bëhet në përputhje me qëllimin e mbledhjes së tyre.

Të dhënat mbahen në tejkalim të afatit vetëm pas informimit paraprak të subjektit dhe dhënies së pëlqimit prej tij në mënyrë të qartë, si dhe duke i dhënë/rezervuar të drejtën për të refuzuar. Procesi i shkatërrimit realizohet në mënyrë të pakthyeshme.

Të dhënat personale që përpunohen me anë të këtyre shërbimeve nuk duhet të transferohen jashtë territoreve të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, pa marrë më parë opinionin e autoritetit përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale.

14. Subjektet përpunuese përcaktojnë hapat që duhen ndërmarrë në rast incidentesh të shkeljes së sigurisë së të dhënave personale. Pas rezultatit të analizës së riskut, duhet të propozohet zbutja e duhur e rreziqeve në një nivel të pranueshëm. SMSI-ja duhet të përfshijë edhe marrëveshjet specifike për vazhdimësinë e veprimtarisë tregtare, për vendosjen e të cilave zbatohen standardet teknike dhe rekomandimet e vëna në dispozicion për publikun.

15. Dokumentacioni i SMSI-së mbahet nga personi i kontaktit për çështjet e mbrojtjes së të dhënave, i emëruar nga subjekti përpunues i të dhënave personale. Ky dokumentacion duhet të vihet në dispozicion të Komisionerit, me kërkesën e tij, brenda afatit të përcaktuar në kërkesë nga data e marrjes dijeni.

KAPITULLI II POLITIKA E SIGURISË SË INFORMACIONIT

16. PSI-ja duhet të hartohet dhe zbatohet përkatësisht nga subjekti përpunues i të dhënave personale.



17. PSI-ja hartohet dhe mbahet në përputhje me rregullat e sigurisë së informacionit, siç përcaktohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe legjislacioni ndërkombëtar që rekomandohet nga standardet e përcaktuara të sigurisë, si dhe rekomandimet e Komisionerit. Analiza e riskut është pjesë përbërëse e PSI-së. Dokumenti i PSI-së specifikon qartë objektivat e sigurisë dhe përcakton masat teknike, organizative edhe në lidhje me personelin, për zbutjen e kërcënimeve dhe rreziqeve që prekin sistemet e arkivimit.

18. Në strukturimin e PSI-së, u kushtohet vëmendja e duhur standardeve teknike të sigurisë së informacionit, kodeve të praktikës së mirë, si dhe rekomandimeve e udhëzimeve të veçanta të miratuara nga Komisioneri. PSI-ja, do të mbulojë aspektet e mëposhtme të sigurisë së informacionit të të dhënave personale:

a) Vlerësimin dhe trajtimin e riskut përmes kryerjes së analizës së riskut ndaj sigurisë së informacionit të subjektit përpunues;

b) Politikën e Sigurisë e cila nënkupton miratimin dhe zbatimin e dokumentit që vërteton mbështetjen dhe angazhimin që ka struktura drejtuese e subjektit ndaj sigurisë së informacionit;

c) Organizimin e sigurisë së informacionit nëpërmjet marrjes së masave për mbrojtjen e informacionit dhe sistemeve të tij nga aksesit i paautorizuar dhe nëpërmjet kryerjes së kontrolleve të sigurisë;

ç) Menaxhimin e asetëve, duke përditësuar inventarin e të gjitha mjeteve të përpunimit dhe klasifikimin e kushteve të sigurisë për të përcaktuar se çfarë do të mbrohet, pse dhe si;

d) Sigurinë e burimeve njerëzore nëpërmjet marrjes së masave të sigurisë për punonjësit që rekrutohen, lëvizin dhe largohen nga subjekti përpunues;

dh) Sigurinë fizike dhe mjedisore nëpërmjet mbrojtjes së pajisjeve kompjuterike;

e) Menaxhimin e komunikimeve dhe operacioneve nëpërmjet kontrolleve të sigurisë teknike në sisteme dhe rrjete kompjuterike;

ë) Kontrollin e aksesit nëpërmjet kufizimit të të drejtave të aksesit në rrjet, sisteme, aplikime, funksione dhe të dhëna;

f) Blerjen, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të përpunimit të informacionit nëpërmjet ndërtimit të sigurisë në aplikacione;

g) Menaxhimin e shkeljeve të sigurisë së

informacionit (referuar si incidente) nëpërmjet parashikimit dhe dhënies së kundër përgjigjes ndaj shkeljeve të sigurisë së informacionit;

gj) Menaxhimin e vazhdimësisë së veprimtarisë tregtare nëpërmjet mbrojtjes, ruajtjes dhe rikuperimit të proceseve e sistemeve kritike;

h) Sigurimin e pajtueshmërisë me politikat e veçanta të sigurisë së informacionit, standardet, ligjet dhe rregulloret.

19. Gjatë zbatimit të dispozitave të këtij kapitulli, trajtohen në mënyrë të veçantë nga PSI-ja:

a) Përpunimi i të dhënave sensitive;

b) Menaxhimi i të drejtave të aksesit;

c) Rreziqet që vijnë nga aksesit në rrjetet publike, veçanërisht nga interneti.

20. PSI-ja specifikon objektivat bazë të sigurisë që duhet të arrihen për mbrojtjen e sistemit të arkivimit të të dhënave personale kundër shkeljes së sigurisë së saj dhe, në veçanti, ajo duhet të:

a) Përcaktojë objektiva të sigurisë bazë dhe masa për sigurinë minimale të kërkuar;

b) Përcaktojë masa teknike, organizative edhe në lidhje me personelin për sigurimin e të dhënave personale në sistemin e arkivimit dhe mënyrën e përdorimit të tyre;

c) Bëjë përshkrimin e sistemit të arkivimit dhe lidhjen e tij me shkelje të mundshme të sigurisë;

ç) Bëjë përkufizimin e kufijve që përcaktojnë rreziqet e mbetura.

21. Analiza e sigurisë së sistemit të arkivimit nënkupton një analizë të detajuar të gjendjes së sigurisë, duke përfshirë, në veçanti:

a) Analizën e riskut, në të cilën identifikohen kërcënimet që prekin pjesë individuale të sistemit të arkivimit, të afta të shkelin sigurinë apo funksionimin e tij; rezultati i analizës së riskut do të jetë një listë e kërcënimeve që mund të rrezikojnë konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave personale të përpunuara, ndërkohë që ajo do të deklarojë edhe shkallën e riskut të mundshëm, propozimet e masave për eliminimin apo minimizimin e ndikimit të riskut dhe një listë të rreziqeve të mbetura.

b) Përdorimin e standardeve të sigurisë dhe përcaktimin e metodave të tjera dhe mjeteve për mbrojtjen e të dhënave personale; vlerësimin e përshtatshmërisë së masave të sigurisë të propozuara nga standardet e sigurisë të aplikuar, metodat dhe mjetet do të përbëjnë një pjesë të analizës së sigurisë së sistemit të arkivimit.



c) Hartimin e rregulloreve të detajuara mbi sigurinë të cilat do të specifikojnë dhe zbatojnë rezultatet që dalin nga SMSI-ja, sipas kushteve konkrete të sistemit të arkivimit të vënë në punë të cilat do të përfshijnë, në veçanti:

i. përshkrimin e masave teknike, organizative edhe në lidhje me personelin të përcaktuara në SMSI dhe përdorimin e tyre në kushtet konkrete;

ii. shtrirjen e kompetencave dhe përshkrimin e veprimtarive të lejuara të personave individuale që i gëzojnë ato të drejta, mënyrën e identifikimit të tyre dhe verifikimin gjatë aksesimit në sistemin e arkivimit;

iii. objektin e përgjegjësisë së personave të ngarkuar dhe të personit të kontaktit;

iv. mënyrën, formën dhe periodicitetin e kryerjes së aktiviteteve të inspektimit të fokusuara në vëzhgimin e sigurisë së sistemit të arkivimit;

v. procedurat gjatë avarive, dështimeve dhe situatave të tjera të jashtëzakonshme, duke përfshirë masat parandaluese për kufizimin e zhvillimit të situatave të jashtëzakonshme dhe mundësive për një restaurim efikas të gjendjes njësoj si përpara avarisë.

KAPITULLI III

RASTE TË VEÇANTA TË PËRPUNIMIT

22. Për subjektet që përpunojnë të dhëna personale në mënyrë manuale zbatohet dispozitat e mëposhtme:

a) Të gjitha dokumentet e përpunuara në mënyrë manuale ruhen të sigurta, në mënyrë që të parandalohet përhapja, shkatërrimi, humbja e paligjshme, si në vendin e punës, ashtu edhe gjatë transferimit të tyre.

b) Vënia në dispozicion e kopjeve të kërkuara, mund të kryhet me kusht që të jetë i mundur gjurmimi i përdorimit të tyre të mëtejshëm deri në shkatërrimin ose anonimizimin e tyre.

c) Me mbarimin e periudhës së ruajtjes, dokumentet:

i. arkivohen, në rast se ekziston një detyrim i tillë ligjor; ose

ii. shkatërrohen fizikisht në mënyrë të pakthyeshme; ose

iii. bëhen anonime duke i kthyer të dhënat personale që ato mbajnë të pallexueshme, në mënyrë të parevokueshme.

ç) Në rast se nuk është përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, i cili rregullon përpunimin e

veçantë të të dhënave, periudha e mbajtjes së të dhënave përcaktohet nga çdo kontrollues, në përputhje me qëllimin e mbledhjes së të dhënave. Për çdo ndryshim në afatin e ruajtjes, kontrolluesi rivlerëson kohën e ruajtjes, si dhe njofton subjektin e të dhënave. Pas përfundimit të periudhës së mbajtjes së të dhënave, subjekti i të dhënave hiqet në mënyrë të pakthyeshme nga të gjitha sistemet aktive të përpunimit të të dhënave, automatik, manual apo të anonimizuar.

23. Për subjektet që përpunojnë të dhëna sensitive, si në mënyrë manuale ashtu edhe elektronike, rregullat shtesë të mëposhtme do të jenë të zbatueshme, përkatësisht për çdo mënyrë përpunimi:

a) Vëmendje e veçantë i kushtohet parandalimit të përhapjes së paligjshme:

i. në rast përpunimi manual, SMSI-ja parashikon procedura shtesë specifike për trajtimin e dokumenteve shkresore, me qëllim parandalimin e aksesit nga persona të paaautorizuar në të dhënat personale që përmbajnë këto dokumente, gjatë gjithë ciklit jetësor të tyre;

ii. në rast transferimi elektronik të të dhënave personale, kanalet e transmetimit apo dokumentet që përmbajnë këto të dhëna do të kodohen, duke përdorur mënyra kodimi në përputhje me rezultatet e analizës së riskut të kryer më parë;

iii. në rast përdorimi të mjeteve elektronike portative si mbartës të informacionit, të dhënat do të kodohen përpara se të largohen nga mjediset e subjektit përpunues të të dhënave. Ky kodim këshillohet të kryhet, gjithashtu, edhe për të dhënat josensitive.

KAPITULLI IV

TRAJNIMI I PERSONELIT TË SUBJEKTTË PËRPUNUES TË TË DHËNAVE PERSONALE

24. Personeli i subjektit përpunues të të dhënave personale trajnohet rregullisht për mbrojtjen e të dhënave personale. Trajnimi kryhet sipas planit të përcaktuar më poshtë:

a) Personeli që përpunon të dhëna personale trajnohet të paktën një herë në vit;

b) Personeli përveç përcaktimit në shkronjën “a”, trajnohet për të gjithë rastet e veçanta të listuara më poshtë:

i. pas çdo ndryshimi thelbësor të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale;



ii. pas çdo ndryshimi thelbësor të kuadrit ligjor evropian për mbrojtjen e të dhënave personale, i cili paraprakisht publikohet në faqen zyrtare të Komisionerit;

iii. pas ndryshimit të organizimit të SMSI-së, veçanërisht të PSI-së;

iv. pas ndryshimit të procedurave të veçanta të sigurisë së përpunimit të të dhënave personale të subjektit përpunues.

Qëllimi i trajnimit dhe forma e organizimit të tij duhet të zbatohen në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi.

25. Subjekti përpunues i të dhënave personale siguron trajnim profesional për personat e ngarkuar të caktuar. Komisioneri mund t'i kërkojë subjektit përpunues të të dhënave personale të sigurojë prova për zhvillimin e trajnimit profesional.

KAPITULLI V KONTROLLI I SIGURISË SË INFORMACIONIT TË SUBJEKTT PËRPUNUES TË TË DHËNAVE PERSONALE

26. Kontrolli i sigurisë së informacionit (të dhënave personale) nga subjektet përpunuese kryhet jo më pak se një herë në vit.

Komisioneri mund të kërkojë vënien në dispozicion të raporteve të kontrollit.

KAPITULLI VI PERSONI I KONTAKTIT NË SUBJEKTET PËRPUNUESE

27. Subjekti përpunues i të dhënave personale është përgjegjës për mbikëqyrjen e brendshme të mbrojtjes së të dhënave personale të përpunuara. Çdo subjekt që i nënshtrohet këtij udhëzimi do të autorizojë me shkrim të paktën një person të ngarkuar, për të kryer këtë mbikëqyrje. Subjekti përpunues do të njoftojë Komisionerin për autorizimin e vetëm një personi të kontaktit, edhe në rast se ai mund të emërojë disa për mbikëqyrjen e brendshme të mbrojtjes së të dhënave personale. Nëse subjekti zëvendëson personin e kontaktit, ai duhet të njoftojë Komisionerin jo më vonë se 14 ditë nga data e zëvendësimit.

28. Përpunuesi, objekt i këtij udhëzimi, emëron një ose më shumë persona të ngarkuar, përgjegjës për garantimin e sigurisë së përshtatshme të të dhënave personale, kur vepron në emër të kontrolluesit. Përpunuesit e vegjël të kontraktuar

nga subjekti përpunues që i nënshtrohet këtij udhëzimi, gjithashtu, këshillohet të emërojnë një person të ngarkuar.

29. Personi i kontaktit mund të jetë çdo person që plotëson kushtet e mëposhtme:

a) Gëzon zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;

b) Gëzon integritet;

c) Ka arsim të lartë juridik ose shkenca kompjuterike;

ç) Shquhet për aftësi profesionale dhe figurë të pastër etiko-morale;

d) Ka eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në profesionin e juristit ose të ekspertit të IT-së ose ka punuar më shumë se 3 vjet në institucionin e Komisionerit me detyrën e juristit ose ekspertit IT;

dh) Nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

Ai dorëzon vërtetim të gjendjes gjyqësore të përditësuar, e cila mbahet nga kontrolluesi gjatë kryerjes së funksionit të tij.

30. Përpara fillimit të përpunimit të të dhënave personale në sistemin e arkivimit, personi i kontaktit vlerëson riskun e shkeljes së të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave. Kjo analizë është pjesë përbërëse e “Analizës së ndikimit në të dhënat personale”.

31. Personi i kontaktit, në kohën e duhur, njofton me shkrim subjektin përpunues të të dhënave për çdo rrezik shkeljeje të të drejtave të subjekteve të të dhënave, përfshirë shkeljen e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

32. Në rast se, pas njoftimit të personit të kontaktit, subjekti përpunues i të dhënave personale, dështon në marrjen e masave të duhura për trajtimin e problemit në kohën e duhur, personi i kontaktit njofton Komisionerin pa vonësë.

33. Brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të mbikëqyrjes së brendshme, subjekti përpunues i të dhënave personale që ka autorizuar personin e kontaktit do të njoftojë Komisionerin. Njoftimi duhet të përmbajë:

a) Emrin, adresën, numrin e identifikimit (NIPT-in) dhe/ose përfaqësuesit ligjor të subjektit;

b) Gjeneralitetet e personit të kontaktit;

c) Pozicionin e personit të kontaktit brenda subjektit përpunues;

ç) Datën e emërimit më shkrim të personit të kontaktit;



d) Deklaratën e subjektit përpunues ku përcaktohet se personi i kontaktit plotëson kushtet e parashikuara në pikën 29.

34. Personi i kontaktit ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) Është përgjegjës për mbikëqyrjen e brendshme, të përmbushjes së detyrimeve për mbrojtjen e të dhënave personale nga ana e subjektit përpunues të të dhënave personale;

b) Jep këshilla për personat përgjegjës;

c) Është përgjegjës për zbatimin e masave teknike, organizative edhe në lidhje me personelin, si dhe mbikëqyr zbatimin e tyre në praktikë. Në veçanti, ai do të sigurojë dokumentacionin e SMSI-së që provon hartimin dhe mirëmbajtjen e duhur të saj;

ç) Në rast kontraktimi të një përpunuesi nga ana e subjektit përpunues të të dhënave personale, personi i kontaktit është përgjegjës për mbikëqyrjen e brendshme të veprimtarisë së përpunuesit, për përmbajtjen dhe hartimin e kontratës me shkrim për përpunuesin. Gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies kontraktuale apo autorizimit, personi i kontaktit do të verifikojë respektimin e kushteve të miratuara, duke përfshirë edhe angazhimin dhe ndryshimin e përpunuesve, në rast se ka;

d) Është përgjegjës për mbikëqyrjen e brendshme të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale;

dh) Është përgjegjës për dorëzimin e dokumentacionit të sistemeve të arkivimit për regjistrim të veçantë dhe shpalljen e ndryshimeve dhe çregjistrimin e sistemeve të arkivimit nga regjistri i veçantë. Ai mban të dhëna të sistemeve të arkivimit që nuk janë subjekt regjistrimi dhe i vendos ato në dispozicion të kujtdo që ligjërisht ka të drejtë të ketë akses në to;

e) Është përgjegjës për bashkëpunimin e nevojshëm me Komisionerin, në përmbushjen e detyrave brenda përgjegjësisë së tij;

ë) Me kërkesën e Komisionerit, ai është i detyruar t'i paraqesë autorizimin me shkrim mbi bazën e të cilit ai vepron, si dhe dëshmi për shkallën e njohurive të fituara në trajnime profesionale.

35. Pas caktimit të personit të kontaktit për mbikëqyrjen e brendshme të mbrojtjes së të dhënave personale, subjekti përpunues i të dhënave personale përjashtohet nga detyrimi për të paraqitur për regjistrim sistemet e arkivimit të të dhënave josensitive.

36. Personi i kontaktit siguron mbajtjen e rregullt të një inventari të sistemeve të arkivimit të të dhënave personale të përpunuara nga subjekti përpunues i të dhënave personale, përfshirë të dhënat personale të përjashtuara nga detyrimi për regjistrim në autoritetin e Komisionerit.

37. Aksesit në këtë inventar të sistemeve të arkivimit të të dhënave personale i ofrohet autoritetit të Komisionerit dhe subjekteve të të dhënave personale, të dhënat e të cilëve përpunohen në sistemin e veçantë të arkivimit, mbi bazën e një kërkesë, pa vonesë.

38. Subjekti përpunues i të dhënave personale është i detyruar t'i mundësojë personit të kontaktit të zbatojë mbikëqyrjen e brendshme të mbrojtjes së të dhënave personale, në mënyrë të pavarur dhe të pranojë propozimet e ligjshme të tij. Njoftimi i mangësive ose bërja e një kërkesë nga personi i kontaktit, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të tij nuk duhet të bëhet nxitje apo arsye për kryerjen e një veprimi nga ana e subjektit, në dëm të personit të kontaktit.

39. Komisioneri ka të drejtë t'i komunikojë dhe t'i kërkojë subjektit përpunues të të dhënave personale për të autorizuar një person tjetër të ngarkuar për mbikëqyrjen e brendshme të mbrojtjes së të dhënave personale, me kusht që të jetë vërtetuar se ai, i cili fillimisht ka qenë i autorizuar, ka dështuar ose nuk ka përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimet e tij ose ka vlerësuar gabimisht, ose ka aplikuar gabimisht në praktikë të drejtat dhe detyrimet e subjektit të parashikuara nga ky akt, ose nuk përmbush kushtet profesionale apo etike.

40. Subjekti përpunues i të dhënave personale është i detyruar të përmbushë kërkesën e Komisionerit në kohën e duhur dhe të autorizojë, brenda 15 ditëve, një person tjetër për mbikëqyrjen e brendshme.

41. Nëse nuk është e mundur, për arsye objektive, të zbatohet afati i përcaktuar në pikën 40, Komisioneri do të ofrojë një muaj shtesë për subjektin përpunues të të dhënave personale.

KAPITULLI VII RREGULLAT E PAJTUESHMËRISË

42. Rregullat e mëposhtme ndiqen për të garantuar pajtueshmërinë e duhur me këtë udhëzim:

a) Të miratohet përqasja formale e analizës së riskut ndaj sigurisë së informacionit, bazuar mbi



standardet e sigurisë së informacionit, në mënyrë që mbrojtja e të dhënave personale të jetë pjesë e pandarë e SMSI-së brenda subjektit përpunues;

b) Nëse subjekti përpunues ka vendosur të certifikojë pajtueshmërinë e tij me standardet teknike të sigurisë, ai duhet të vendosë në dispozicion të Komisionerit këtë certifikatë. Procesi i certifikimit për pajtueshmërinë me standardet e sigurisë së informacionit do të përfshijë edhe identifikimin, menaxhimin dhe zbutjen e dobësive dhe rreziqeve të sigurisë së të dhënave personale;

c) Shkeljet e rënda të sigurisë së të dhënave personale duhet të raportohen menjëherë te Komisioneri. Në rast se është emëruar personi i kontaktit atëherë kjo është detyrë e tij.

